

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Protesta - Rama i tmerruar nga fjala e shqiptarëve të Amerikës: Njofton takime me ta dhe nuk i lejon të futen në sallë
ADRESA	https://www.syri.net/politike/918069/rama-i-tmerruar-nga-fjala-e-shqiptareve-te-amerikes-njofton-takime-me-ta-dhe-nuk-i-lejon-te-futen-ne-salle/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	20 shtator 2026, 22:08:49 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	20 shtator 2026, 22:01:57 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	a1cf1babe8cc7d53d9da1cdc479580023d6303032b8671f9af1e55d3d625ca3f
TEKSTI	afdeaaaf32f489bee46590927bf48848e7a4c9152e0cdb145464eeef80efd504
PAMJA	a6fe323f55eb96785e56d7d340aed5759a004d1ca3a9bafbb07c094cb38dd66e

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	28ef2e9b45c67b2cec63633ced53bf4342983501f7926b15f942214901cb7cc5
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/28ef2e9b45c67b2cec63633ced53bf4342983501f7926b15f942214901cb7cc5>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

**ENVER BYTYÇI**Vendimi i Hagës dhe raporti
ynë me të vërtetën!**ENVER ROBELLI**Qëndrimi i Zagrebit dhe
heshija e Tiranës**më të lexuarat**

Takimi sekret i DEA-s me vendet e
Amerikës Latine/ Si po i damkos
shqiptarët narko-shteti i Edi Ramës

Ura shembet 1 javë pas inaugurimit/
Vata: 40 mln lekë nga paratë e qytetarëve
të hedhura në lumë

By Pass i Elbasanit/ 'Karakaçi në rrugën
e Ballukut', Himci: S'dihet kur do
përfundojë, tenderat po vidhen

Bardhi - Ramës: Po hakmerresh ndaj
gjyqtarëve dhe prokurorëve se të trokitën
në derë për aferat ku je zhytur

Diaspora ngrihet sot në protesta në
mbështetje të ish-krerëve të UÇK-së

E urdhëroi Taulant Balla/ Bajram Begaj
firmos me urgjencë ligjin e Ramës për
pagat e magistratëve



Rama i tmerruar nga fjala e shqiptarëve të
Amerikës: Njofton takime me ta dhe nuk i
leion të futen në sallë



00:01, 21/09/2026

ZMADHO TEKSTIN



Edi Rama nuk gjen qetësi nga protestuesit si në Shqipëri ashtu edhe kudo ku shkon jashtë vendit.

Gjatë vizitës së tij në Michigan, ku ka njoftuar gjoja për takime me diasporën, denoncimet që vijnë nga shqiptarët që jetojnë në Michigan nxjerrin në pah tmerrin që ka KM nga qytetarët e vet.

Shqiptarë të diasporës dhe aktivistë kanë përcjellë te **Syri** një denoncim mbi mënyrën e organizimit të takimit, duke ngritur akuza për mungesë transparence, përzgjedhje të pjesëmarrësve dhe tentativa për të kufizuar kundërshtimet.

Sipas informacionit të përcjellë, organizatorët kanë shpërndarë në mënyrë jo publike një flyer ku thuhet se komuniteti është i ftuar dhe se hyrja është e lirë.

Por aktivistët thonë se nuk ka pasur një njoftim të qartë publik mbi organizatorët, mënyrën e rezervimit apo kontaktet për pjesëmarrje.

Pikërisht këtu ngrihet edhe pyetja kryesore: **nëse Edi Rama shkon në Michigan si Kryeministër i Shqipërisë, përse takimi nuk bëhet në mënyrë të hapur dhe transparente për të gjithë komunitetin?**

Aktivistët bëjnë dallimin mes një takimi të Ramës si kryetar i Partisë Socialiste apo një takimi privat dhe një aktiviteti në cilësinë e Kryeministrit të Shqipërisë.

Sipas tyre, në rastin e dytë, askush nuk mund të përzgjedhë se cilët shqiptarë mund të marrin pjesë apo të pretendojë se përfaqëson të gjithë komunitetin.

Aktivistët thonë se kanë mësuar se kush janë disa prej organizatorëve pasi këta të fundit i kanë kontaktuar, duke u kërkuar të mos shkruajnë, komentojnë apo organizojnë protestë.

Ata pretendojnë gjithashtu se ftesat janë bërë në mënyrë selektive.

Një prej aktivistëve thotë se ka kërkuar të marrë pjesë në sallë së bashku me një grup prej të paktën 20 personash dhe se ka marrë premtime për ftesa, por deri tani nuk ka marrë asnjë njoftim.


Ata kanë kërkuar që të hapet salla e plotë e **Hotel Marriott**, e cila ka kapacitet të madh, në mënyrë që të marrë pjesë kushdo që ka dëshirë dhe të kenë mundësi të shprehin qëndrimet e tyre brenda sallës, në mënyrë paqësore dhe demokratike.



Korrupsioni mbetet 'thembra e Akilit' në Kadastër

Situata alarmante me kontratat publike dhe koncesionet, Grupi PD propozon paketë ligjore: Gjurmim e kontroll çdo pasurie publike

Mësuesja e arrestuar në Shqipëri me urdhër të Erdoganit/ Kolegët dhe nxënësit e saj protestojnë në Francë



Ndërkohë, sipas informacionit të përcjellë të **Syri**, ka edhe pretendime për kërcënime ndaj personave që synojnë të marrin pjesë në protestë anti-Rama.

Në kushtet kur, sipas aktivistëve, nuk është krijuar mundësia për të marrë pjesë në takim dhe për t'ia drejtuar drejtpërdrejt pyetjet Kryeministrit, ata kanë vendosur të organizojnë një **protestë masive, paqësore dhe civile** përpara hotelit ku zhvillohet pritja.

Thirrja e tyre për protestuesit është e qartë: të ruajnë qetësinë, të mos bien pre e provokimeve dhe të shprehin bindjet e tyre në mënyrë demokratike.

Në fund të denoncimit, aktivistët përcjellin edhe mesazhin politik që qëndron në thelb të protestës:

"Kryeministri Rama do të ikë, por ne do të mbetemi këtu. Uniteti, respekti dhe paqja mes shqiptarëve në Michigan janë pasuria jonë më e madhe."

© SYRI.net

Lexo edhe:



Protestë e shqiptarëve në Detroit: Rama, duart larg diasporës!



Mbyllet protesta e 113-të kundër Edi Ramës, qytetarët priten t'i bashkohen nesër sërish



Rekord punësimesh në pushtetin lokal/ Gati 40 mijë punonjës në bashki, 2-fish më tepër se në 2014

TË NGJASHME



VIDEO/ Thirrja e qytetarit: Ta shërojmë Shqipërinë nga korrupsioni. Fatin tonë e vendosim ne



113 ditë rezistencë/ Qytetarët sërish në protestë para Kryeministrit: Rama jepe dorëheqjen

Donika Gërvalla është simbol i drejtësisë dhe të së vërtetës!



'Rusia synon përçarjen'/ Burimi: Sulmet hibride për të sjellë në pushtet forcat që nuk ndihmojnë Ukrainën

113 ditë protestë/ Qytetarët mbërrijnë para Kryeministrit, kërkojnë dorëheqjen e Ramës



Ura shembet 1 javë pas inaugurimit/ Vata: 40 mln lekë nga paratë e qytetarëve të hedhura në lumë

FOTO/ Protesta, dita e 113-të, pankartat: Kur ne përçahemi, 'trajneri' feston në pushtet

LAJME POLITIKË KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË/STIL TRASHËGIMI MEDIË ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do t'i gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojme të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.